

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË, Departamenti i përgjithshëm penal, gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit M.A. nga Gj., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.508/2018, të datës 11.05.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor më datë **29.10.2018**, në prezencën e përfaqësuesit të Prokurorisë – Prokurorit Ismet Tofaj, i akuzuari M.A., mbrojtësi av. I. H. sipas autorizimit si dhe e dëmtuara A. R., mori dhe të njëjtën ditë publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **M.A.** nga Lagjja D., rr.“L.D.”, Komuna e Gj., ku edhe tani banon, i biri i D. dhe i nënës F. e gjinisë G., i lindur me dt. data e lindjes..., në Gj., ka te kryer shkollën e mesme, i gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar, nr.ID

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse:

-me dt.27.03.2018, rreth orës 18:00 min, përgjatë aksit rrugor Gj.-D. pikërisht në rr. “N.T.” përballë qendrës tregtare E.. në Gj. duke drejtuar automjetin e tij të tipit D.Ch., ngjyrë hiri metalike, me targa regj....., duke mos respektuar rregullat e komunikacionit rrugorë, ka rrezikuar trafikun publikë dhe jetën e të dëmtuarës Sh.R. nga fshati G. K. D., ashtu që ka drejtuar automjetin në kundërshtim me nenin 53, 54 dhe nenin 120 të ligjit për rregullat e komunikacionit rrugor edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se me një veprim të tillë do të vij deri tek pasoja, lehtas e ka marrë se gjer tek ajo nuk do të vjen apo në momentin e duhur do ti shmanget, në atë mënyrë me të arritur tek qendra tregtare E. në Gj., gjersa po lëvizte rrugës kryesore në D. drejtimi për Gj. papritmas me pjesën e parë ballore të krahut të majtë e godet prapa në krahun e djathtë automjetin ..., ngjyrë e zezë metalike, me targa regj.... me vozitës A.R. ashtu që duke mos mbajtur distancën e mjaftueshme nga goditja shkaktohen dëme materiale automjete si dhe dëmtime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit për të dëmtuarën Sh.R. nga fshati G., Komuna e D., gjendje kjo e konstatuar nga ekspertiza mjeko-ligjore e Dr.N. U. të dt.25.04.2018.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6-1 të KPRK-ës.

Andaj Gjykata në bazë te nenit 4,41,85,86 par. 1.2 dhe 5 të KPRK-ës neni 378/6-1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

VËREJTJE GJYQËSORE

Të akuzuarit **M. A.**, i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën vepër penale dhe nëse ai serish kryen vepër të tillë ,gjykata do te iu shqiptojë sanksion me te rende penal.

E dëmtuara A. R., për të realizuar kërkesën e vet pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që te paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 101.10 euro (ne emër te ekspertizës mjeko –ligjore 50 euro si dhe ne emër te ekspertizës se komunikacionit 51.10 euro) si dhe ne emër të paushallit gjyqësor ne shumë prej **20.00.-€** ,ne afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë se këtij Aktgjykimi.

Ar sy e t i m

Prokuroria Themelore në Gj., me Aktakuzën PP.nr.508/2018 të datës 11.05.2018, e ka akuzuar të akuzuarin M.A. nga Gj., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6-1 të KPRK-ës, duke propozuar që ndaj të akuzuarit të nxjerrë urdhër ndëshkimor me të cilin të njëjtit ti shqiptohet një dënim me gjobë. Gjykata ka pranuar kërkesën e PTH-DP dhe jashtë shqyrtimit gjyqësor me dt.03.09.2018, ka marrë Aktgjykim –Urdhër Ndëshkimor P.nr.360/18, me të cilën të akuzuarin e shpall fajtor dhe e dënon me gjobë në shumën prej 200 euro, i njëjti është obliguar që të paguaj shpenzimet procedurale në shumën prej 71.10 euro dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 30 euro, krejt këtë në afat prej 15 ditësh nën kërcënim e përmbarimit me dhunë. Në afatin ligjor i akuzuari ka parashtruar kundërshtim kundër urdhrorit ndëshkimor me numër P.nr.360/18 i datës 03.09.2018, për çka gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësor.

Përfaqësuesi i Prokurorisë, Prokuror Ismet Tofaj, gjatë shqyrtimit gjyqësor, të mbajtur me dt.29.10.2018, lexon aktakuzën PP.nr.508/2018 të datës 11.05.2018 dhe deklaroi se mbetet në tersi pranë aktakuzës por bënë përmirësimin e të dhënave personale si në procesverbal. I propozoi gjykatës që pas nxjerrjes dhe administrimit të provave i akuzuari të shpallet fajtor për veprën penale me të cilën akuzohet të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale. Ne fjalën përfundimtare deklaroi se me pranimin e fajësisë nga i akuzuari e qe u be i lirshëm e vullnetshëm duke i kuptuar pasojat u vërtetu mjaftë edhe pse nga shkresat e lendes ka edhe prova tjera bindëse se ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 te KPRK-ës , e gjykatës i propozoi qe te njëjtin ta shpall fajtor për shkallen e përgjegjësisë penale te ta dënoi sipas ligjit dhe ta detyroi ne pagesën e shpenzimeve te procedurës, duke i çmuar rrethanat e pranimin te fajësisë ,mos dënueshmeria e tij e me parshme .

I akuzuari M. A., lidhur me fajësinë thekson pas konsultimit me mbrojtësin e tij av. I. H.deklaroi se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimin të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion. Ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare te mbrojtësi te tij te dhënë gjatës shqyrtimit gjyqësor .

E dëmtuara A.R. , deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi me qe te njëjtën e kam realizuar nga kompania e sigurimeve .

Mbrojtësi i te akuzuarit av. I. H. ne fjalën përfundimtare deklaroi se mbetem ne tërësi pranë deklarimeve te dhëna ne kundërshtim e gjykatës i propozoi qe me rastin e marrjes se vendimit te këtë parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë ne çdo fazë te procedurës gjendjen e tij te dobët ekonomike , tendenca pas kryerjes se veprës penale dhe kërkim falja e bere pas kryerjes se veprës penale ,pendimi i shprehura ne gjykatë, premtimi i tij se ne ta ardhëm do tej ete me i kujdesshme si dhe faktin se me pare nuk ka qene i dënuar ,po ashtu gjykatës i propozoi qe duke i njohur rrethanat e tija ekonomike familjare ,shpenzimet procedurale e rendojnë edhe me shumë ekonomin familjare dhe është e pamundur ti mbulojë shpenzimet procedurale ku gjykate i kemi pruar edhe provave materiale në formë shkresore dhe vërtetimin e papunësisë se te akuzuarit dhe i le gjykatës qe te aprovohet propozimi dhe te shqiptohet dënimi sa me i butë apo vërtetje gjyqësore.

I akuzuari M.A. , ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se e mbështet ne tërësi fjalën përfundimtare te mbrojtësi te tij te dhënë gjatës shqyrtimit gjyqësor .

Pasi që Gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, për veprën penale, që i vihet në barrë, dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban propozim akuza , ka gjetur se janë përmbushur

të gjitha kushtet ligjore nga neni 326 par. 4, të KPPK-së, shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese nuk gjeti, ndërsa si rrethana lehtësuese, Gjykata ka marr parasysh pranimin e fajësisë nga i akuzuari, pendimin e tij, mosha e tij e re , gjendjen e dobët ekonomike, deklarami i te dëmtuarës se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim demi me qe te njëjtën e ka realizuar nga kompania e sigurimeve , si dhe faktin se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar. Nisur nga të gjitha këto Gjykata i shqiptoi **vërejtje gjyqësore**, me bindje se në rastin konkret është adekuate me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit. Gjykata beson se me shqiptimin e sanksionit të tillë, pra, me vërejtje gjyqësore do të arrihet qëllimi i dënimi i paraparë në dispozitën e nenit 41 të KPRK-ës, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryej vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuara në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marr konform nenit 463 par. 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor, është marr konform nenit 450 par. 2 nën paragraf 2.6 të KPPK-së.

Nga se u tha më lart, u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P. nr.360/18 të dt.29.10.2018.

Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci

Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej **15 dite**, nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë , nëpërmjet të kësaj Gjykate.